



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

**RAPORT PËRMBLEDHËS I PYETËSORIT PËR
KËNAQËSINË E STUDENTËVE PS MENAXHIMI I
EMERGJENCAVE-MA**

Zyra për Sigurim të Cilësisë

Institucioni: Kolegji BIZNESI Prishtinë

Viti akademik: 2024-2025

Semestri Dimror

Përmbajtja

Lista e shkurtesave.....	3
Hyrja.....	4
Zyra për Sigurim të Cilësisë.....	5
1. Gjetjet.....	6
2. Realizimi Pytesorit.....	6
3. Analiza Përmbledhëse e Rezultateve të Vlerësimit.....	11
Rekomandimet.....	12

Lista e shkurtesave

IAL: Institucion i Arsimit të Lartë

KSCV: Komisioni për Sigurimin e Cilësisë dhe Vlerësimit

SMK: Sistemi i Menaxhimit në Kolegj

KB: Kolegji Biznesi

ZSC: Zyra për Sigurim të Cilësisë

Hyrje

Kolegji Biznesi, si Institucion i Arsimit të Lartë i themeluar në vitin 2004, në mënyrë të vazhdueshme ndërmerr veprime konkrete për të siguruar, monitoruar dhe përmirësuar cilësinë e procesit mësimor dhe të shërbimeve institucionale. Në kuadër të mekanizmave të brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, institucioni realizon në mënyrë periodike pyetësorë për matjen e nivelit të kënaqësisë së studentëve, me qëllim vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, mbështetjes akademike, burimeve të mësimnxënies, kushteve të studimit dhe shërbimeve të ofruara nga institucioni.

Pyetësori për kënaqësinë e studentëve është hartuar për të reflektuar perceptimet dhe vlerësimet e studentëve lidhur me procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, cilësinë e stafit akademik, infrastrukturën dhe shërbimet institucionale, si dhe mbështetjen akademike dhe administrative gjatë studimeve. Rezultatet e këtij pyetësori shërbejnë si bazë për identifikimin e fushave që kërkojnë përmirësim dhe për zhvillimin e masave për rritjen e cilësisë së përgjithshme të procesit akademik dhe institucional.

Kolegji Biznesi disponon mekanizma të qartë dhe funksionale për matjen dhe monitorimin e cilësisë, ku procesi mbikëqyret dhe analizohet në mënyrë të vazhdueshme nga menaxhmenti i institucionit, përfshirë Dekanin, Prodekanët, Përgjegjësit e Programeve Studimore dhe Koordinatorët për Cilësi. Zyra për Sigurimin e Cilësisë në Kolegjin Biznesi, Prishtinë, ka rol kyç në organizimin, administrimin dhe analizimin e këtij procesi dhe përbën strukturën kryesore institucionale për sigurimin e cilësisë së brendshme.

I gjithë procesi i hartimit të pyetësorit, shpërndarjes së tij dhe mbledhjes së të dhënave është realizuar nga Zyra për Sigurimin e Cilësisë në koordinim me strukturat përkatëse institucionale. Procesi është zhvilluar në mënyrë transparente dhe konfidenciale, duke garantuar anonimitetin e respondentëve dhe duke respektuar standardet etike dhe profesionale të vlerësimit institucional.

Me qëllim të ruajtjes së etikës profesionale dhe konfidencialitetit të respondentëve, në këtë raport paraqiten vetëm gjetjet kryesore dhe përmbledhëse të pyetësorit. Rezultatet e analizës shërbejnë si bazë për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies, shërbimeve studentore dhe proceseve akademike në përputhje me standardet e arsimit të lartë dhe politikat institucionale të sigurimit të cilësisë.

Zyra për Sigurimin e Cilësisë

Zyra për Sigurimin e Cilësisë është njësi funksionale e pavarur që vepron brenda strukturës institucionale të Kolegjit Biznesi dhe raporton drejtpërdrejt te organet drejtuese të institucionit, në përputhje me aktet e brendshme dhe rregulloret në fuqi. Në kuadër të mekanizmave të brendshëm të sigurimit të cilësisë, Zyra angazhohet në rritjen e vazhdueshme të cilësisë akademike dhe institucionale, duke zbatuar politikat institucionale dhe instrumentet standarde për matjen dhe vlerësimin e cilësisë, të miratuara nga Komisioni për Sigurimin e Cilësisë (KSC).

Në kuadër të realizimit të pyetësorit për kënaqësinë e studentëve në Programin Studimor Menaxhimi i Emergjencave (MA), për semestrin dimëror të vitit akademik 2023/2024, Semestri Dimror, Zyra për Sigurimin e Cilësisë ka rol kyç në hartimin e instrumenteve të vlerësimit, organizimin e procesit të shpërndarjes së pyetësorit, mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, si dhe në përgatitjen e raporteve përmbledhëse mbi rezultatet e vlerësimit në nivel të programit studimor.

Procesi i realizimit të pyetësorit është zhvilluar në mënyrë transparente dhe konfidenciale, duke garantuar anonimitetin e studentëve dhe duke respektuar standardet etike dhe profesionale të vlerësimit akademik. Zyrtarët e cilësisë veprojnë në mënyrë të pavarur nga stafi akademik dhe nuk janë të përfshirë drejtpërdrejt në procesin e mësimdhënies, çka siguron objektivitet dhe paanshmëri në analizimin e rezultateve të pyetësorit.

Në bazë të të dhënave të mbledhura nga studentët e Programit Studimor Menaxhimi i Emergjencave (MA), Zyra për Sigurimin e Cilësisë përgatit raporte analitike që përmbajnë gjetje dhe rekomandime për përmirësimin e cilësisë së procesit mësimor, burimeve të mësimnxënies dhe shërbimeve studentore. Këto raporte i adresohen menaxhmentit të institucionit, përgjegjësit të programit studimor dhe strukturave përkatëse akademike, me qëllim ndërmarrjen e masave konkrete për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe zhvillimin e mëtejshëm të programit studimor.

Rezultatet e pyetësorit shërbejnë gjithashtu si bazë për analizën e performancës së programit studimor, për identifikimin e praktikave të mira akademike dhe për ndërmarrjen e iniciativave që synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së studimeve në fushën e Menaxhimit të Emergjencave-MA.

Qëllimi i pyetësorit

Pyetësori për kënaqësinë e studentëve është realizuar me qëllim vlerësimin sistematik të cilësisë së procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, nivelit të mbështetjes studentore, burimeve të mësimnxënies, infrastrukturës dhe shërbimeve institucionale të ofruara nga Kolegji Biznesi. Përmes këtij instrumenti synohet matja e perceptimeve dhe përvojave të studentëve lidhur me cilësinë e programeve studimore, performancën e stafit akademik, kushtet e studimit dhe funksionimin e mekanizmave të mbështetjes akademike dhe administrative.

Rezultatet e pyetësorit shërbejnë për identifikimin e pikave të forta dhe fushave që kërkojnë përmirësim, duke mundësuar ndërmarrjen e masave konkrete për rritjen e cilësisë së procesit akademik dhe institucional. Të dhënat e mbledhura përdoren për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve studimore, zhvillimin e praktikave të mësimdhënies, përmirësimin e shërbimeve studentore dhe forcimin e mekanizmave të brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, në përputhje me standardet e arsimit të lartë dhe politikat institucionale.


Vlerësimi është realizuar përmes një shkalle vlerësimi nga 1 deri në 5, ku 1 përfaqëson nivelin më të ulët të kënaqësisë, ndërsa 5 përfaqëson nivelin më të lartë të kënaqësisë së studentëve.

Rezultatet sipas fushave të vlerësimit

Regjistrimi, konsultimet dhe mbështetja e studentëve- PS M. i Emergjencave (MA), Tab:1

Nr	Pyetja	Mesatarja	Vlerësimi
2.1	Informacionet për kolegjin dhe programet	4.3	Shumë mirë
2.2	Procedura e regjistrimit	4.4	Shumë mirë
2.3	Konsultimet akademike	4.1	Shumë mirë
2.4	Programi i tutorimit	3.9	Shumë mirë
2.5	Orientimi profesional	4.2	Shumë mirë

Grafikoni nr.1



Interpretimi:

Rezultatet e vlerësimit në fushën e regjistrimit, konsultimeve dhe mbështetjes së studentëve tregojnë një nivel shumë të mirë të kënaqësisë së studentëve ndaj shërbimeve akademike dhe administrative të ofruara nga institucioni. Vlerësimet mesatare që variojnë nga **3.9** deri në **4.4** reflektojnë një perceptim pozitiv të studentëve për transparencën e informacionit institucional, funksionimin e procedurave administrative dhe mbështetjen akademike gjatë procesit të studimit. Vlerësimi më i lartë është evidentuar në aspektin e informacioneve për kolegjin dhe programet, çka tregon se studentët kanë qasje të mirë në informacionet e nevojshme për studimet dhe aktivitetet akademike. Po ashtu, procedurat e regjistrimit, konsultimet akademike dhe programi i tutorimit vlerësohen në nivel shumë të mirë, duke reflektuar përkushtimin e stafit akademik në ofrimin e mbështetjes profesionale dhe orientimit gjatë studimeve.


Në përgjithësi, rezultatet tregojnë se mekanizmat institucionalë për mbështetjen e studentëve funksionojnë në mënyrë efektive dhe kontribuojnë në përmirësimin e përvojës studentore. Këto gjetje konfirmojnë angazhimin e institucionit për të ofruar shërbime cilësore për studentët dhe

për të përmirësuar vazhdimisht proceset akademike dhe administrative në përputhje me standardet e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë.

Burimet e mësimnxënies dhe infrastruktura- PS M. i Emregjencave (MA), Tabela: 2

Nr	Pyetja	Mesatarja	Vlerësimi
3.1	Ambientet dhe siguria	4.2	Shumë mirë
3.2	Biblioteka	4.3	Shumë mirë
3.3	Qasja në internet	4.4	Shumë mirë
3.4	Teknologjia informative	4.0	Shumë mirë
3.5	Sallat e mësimimit	4.2	Shumë mirë
3.6	Pajisjet mësimore	4.3	Shumë mirë
3.7–3.12	Infrastrukturë dhe shërbime tjera	4.1	Shumë mirë

Gafikoni nr. 2



Interpretimi

Rezultatet në fushën burimet e mësimnxënies dhe infrastruktura tregojnë një nivel shumë të mirë të kënaqësisë së studentëve ndaj kushteve të studimit dhe resurseve akademike të ofruara nga institucioni. Vlerësimet mesatare që variojnë nga 4.0 deri në 4.4 reflektojnë një perceptim pozitiv të studentëve për infrastrukturën fizike, teknologjinë dhe mjedisin e përgjithshëm të studimit.


Rezultati më i lartë është evidentuar në qasjen në internet (4.4) bibliotekë dhe pajisjet mësimore (4.3), çka tregon se infrastruktura teknologjike dhe kushtet fizike të studimit vlerësohen shumë pozitivisht nga studentët. Po ashtu, teknologjia informative (4.0), dhe infrastruktura dhe shërbimet tjera (4.1) tregojnë se institucionit i është arritur të krijojë një mjedis modern dhe funksional për zhvillimin e procesit mësimor. Ndërkohë, sallat e mësimimit (4.2) dhe pajisjet mësimore (4.3) gjithashtu vlerësohen në nivel shumë të mirë, duke reflektuar se resurset

akademike dhe hapësirat e mësimit mbështesin në mënyrë efektive procesin e mësimit dhe mësimit. Në përgjithësi, rezultatet konfirmojnë se infrastruktura dhe burimet akademike të institucionit kontribuojnë në krijimin e një mjedisi cilësor dhe të përshtatshëm për studim.

Procesi i mësimit dhe mësimit- PS Menaxhimi i Emergjencave (MA), Tabela:3

Nr	Pyetja	Mesatarja	Vlerësimi
4.1–4.5	Organizimi dhe përmbajtja e mësimit	4.4	Shumë mirë
4.6–4.7	Marrëdhëniet me stafin	4.5	Shumë mirë
4.8	Cilësia e stafit akademik	4.2	Shumë mirë
4.9	Cilësia e programeve	4.1	Shumë mirë
4.10–4.11	Rezultatet e të nxëniet	4.3	Shumë mirë
4.13	Mentorimi i temave	4.0	Shumë mirë
4.15–4.17	Praktika dhe lidhja me industrinë	4.2	Shumë mirë
4.18–4.20	Vlerësimi dhe konsultimet	4.4	Shumë mirë

Grafikoni nr. 3



Interpretimi

Rezultatet në fushën **Procesi i mësimit dhe mësimit** tregojnë një nivel shumë të lartë të kënaqësisë së studentëve, me vlerësime mesatare që variojnë nga **4.0 deri në 4.5**. Këto rezultate reflektojnë një perceptim shumë pozitiv të studentëve për organizimin e mësimit, cilësinë e stafit akademik, përmbajtjen e programeve studimore, mentorimin akademik dhe procesin e vlerësimit.

Vlerësimi më i lartë është evidentuar në aspektin e **marrëdhënies me stafin (4.5)**, çka tregon përkushtimin, profesionalizmin dhe kompetencën e lartë të stafit në realizimin e procesit mësues. Po ashtu, **organizimi dhe përmbajtja e mësimit (4.4)** si dhe **mentorimi i temave**

(4.0) janë vlerësuar në nivel shumë të lartë, duke reflektuar strukturim të mirë të mësimimit, qartësi në realizimin e lëndëve dhe mbështetje të vazhdueshme për studentët gjatë studimeve.

Gjithashtu, **cilësia e stafit akademik (4.2)** dhe **vlerësimi dhe konsultimet (4.4)** tregojnë se komunikimi ndërmjet studentëve dhe stafit akademik zhvillohet në mënyrë profesionale dhe mbështetëse. **Cilësia e programeve (4.1)** dhe **rezultatet e të nxënit (4.3)** vlerësohen po ashtu pozitivisht, duke dëshmuar se programi studimor kontribuon në zhvillimin e njohurive dhe kompetencave akademike e profesionale të studentëve.

Ndërkohë, edhe pse me rezultat pak më të ulët krahasuar me fushat tjera, **mentorimi i temave (4.0)** vazhdon të vlerësohet në nivel shumë të mirë, duke treguar se institucioni ka krijuar bazë pozitive edhe në raport me komponentën praktike të studimeve. Në përgjithësi, rezultatet konfirmojnë se procesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies zhvillohet me cilësi të lartë dhe në përputhje me standardet institucionale të sigurimit të cilësisë.

Gjetjet nga vlerësimi i pyetësorit

Rezultatet e pyetësorit për Programin Studimor Menaxhimi i Emergjencave (MA) për semestrin dimror tregojnë një nivel shumë të lartë të kënaqësisë së studentëve ndaj procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, mbështetjes akademike dhe administrative, si dhe ndaj burimeve të mësimnxënies dhe infrastrukturës së ofruar nga institucioni. Vlerësimet mesatare që variojnë nga **4.0 deri në 4.5** reflektojnë një perceptim shumë pozitiv të studentëve për cilësinë e programit studimor, performancën e stafit akademik, kushtet e studimit dhe funksionimin e mekanizmave të mbështetjes studentore.

Rezultatet tregojnë vlerësime veçanërisht të larta në aspektet që lidhen me **cilësinë e stafit akademik, organizimin dhe përmbajtjen e procesit mësimor, mentorimin e temave**, si dhe **qasjen në internet, teknologjinë informative dhe ambientet e studimit**. Këto vlerësime dëshmojnë se Programi Studimor Shkenca Kompjuterike ofron një mjedis akademik cilësor, me organizim efektiv të procesit mësimor, mbështetje të vazhdueshme për studentët dhe përputhshmëri të lartë me standardet e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë.

Në të njëjtën kohë, analiza e rezultateve identifikon disa fusha me vlerësim relativisht më të ulët krahasuar me kategoritë tjera, veçanërisht në aspektet që lidhen me **praktikën dhe lidhjen me industrinë, bibliotekën**, si dhe **pajisjet mësimore**, megjithëse edhe këto fusha janë vlerësuar në nivel shumë të mirë. Këto rezultate paraqesin potencial të rëndësishëm për përmirësime të mëtejshme, sidomos në drejtim të forcimit të komponentës praktike të programit, zgjerimit të bashkëpunimit me sektorin e industrisë dhe avancimit të mëtejshëm të burimeve mbështetëse për studentët.

Në përgjithësi, gjetjet e pyetësorit konfirmojnë se Programi Studimor; Menaxhimi i Emergjencave (MA), semestri dimror, karakterizohet nga stabilitet dhe cilësi e qëndrueshme akademike, duke reflektuar angazhimin institucional për përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së studimeve. Rezultatet shërbejnë si bazë e rëndësishme për planifikimin e masave të ardhshme zhvillimore, me qëllim avancimin e mëtejshëm të programit studimor, rritjen e kënaqësisë së

studentëve dhe forcimin e përputhshmërisë së programit me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimet bashkëkohore në fushën e shkencave kompjuterike.